

Italia dhe shqiptarët: shfaqje e rishfaqje të një paradigme të veçantë diskursive¹

“Ëndrra italiane» në këtë kuptim, mund të përshkohet si një palindrom i dëmtuar: ata na kanë ëndrruar ne dhe ne ata, por brenda fazash dhe kushtesh të ndryshme dhe asimetrike. «Një vend interesant dhe misterioz për të cilin përfliten shumë mrekulli por edhe ekzagjerime»² mund të jetë Italia po aq sa dhe Shqipëria.»³

Një postkoloniale *sui generis*

E kthyer në një vend pritës për imigracionin, Italia është e shtrënguar të vihet përballë me alteritetin dhe ta përkufizojë. *Fjalët që e shprehin*⁴ – si i huaj, imigrant, ekstrakomunitar, i palettra (it. *irregolare*), *vu' kumprà*⁵, kujdestare (it. *badante*), refugjat, klandestin, shqiptar, rumun – nxjerrin në pah një diferencim dhe nuanca dalluese në rritje e sipër që kanë ardhur duke u rritur qëkur çështja e imigracionit ka hyrë në debatin publik, duke u politizuar dhe u përshkuar nëpër mjetet e informacionit⁶. Nga këndështimi i përjasjes diskursive ndaj ‘tjetrit’ janë themelore tre faktorë: shëndeti shoqëroro-ekonomiko-demografik i vendit mikpritës, përshtypja e parë dhe ekzistenca (ose jo) e një imagjinate kolektive paraprake, fryt i kontakteve pararendëse. Togfjalëshi që është bërë pjesë e gjuhës së

1 Botuar në italisht me titullin “L’Italia e gli albanesi: corsi e ricorsi di un singolare paradigma discorsivo”, in *Revue Babel – Le postcolonialisme italien: l’inconscient économique-politique d’une notion controversée* (dir. Alessandro Leiduan), 31 (X 2015): 165-188. Versionit shqip i janë shtuar disa të informacione me qëllim kontekstualizimin e të dhënave historike, kulturele dhe terminologjike.

2 Antonio Baldacci, *Itinerari albanesi (1892-1902), con uno sguardo generale all’Albania e alle sue comunicazioni stradali*, Roma: Reale Società Geografica Italiana, 1917, 291.

3 Paolo De Simonis, “Interessante e misterioso paese sul quale si dicono tante meraviglie ed esagerazioni». Luoghi e costruzioni comuni nelle memorie di viaggiatori, sacerdoti, militari”, in *Palaver*, 2 n.s. (2013): 101-182, këtu 103.

4 Shih Donata Castagnoli/ Flavia Cristaldi (eds), *Le parole per dirlo. Migrazioni, comunicazione e territorio*, Perugia: Morlacchi, 2012.

5 Për “trajektoren semantike” të këtij neologjizmi, të përhapur nga gjysma e dytë e viteve ’70 të shekullit të shkuar e këtej, fillimisht me nuancë shakaje, që emërton shitësit ambulante nga Afrika veriore nëpër plazhet italiane, krhs. Corrado Giustiniani, “Ma vu’ cumprà è una parolaccia?”, in *L’Espresso*, 11.08.2014.

6 Shih Frank Baasner/ Lucia Cantini, “Einwanderung – Integration: Traditionen und Brüche im italienischen Diskurs”, in: Frank Baasner (ed), *Migration und Integration in Europa*, Baden-Baden: Nomos, 2010, 117-136, këtu 132-133.

përditshme ‘kam filipinen në shtëpi’ (it. *avere la filippina*), me fjalë tjera, të kesh një bashkëpunëtoreshë shtëpiake, është tregues i një kontakti ‘të qetë’, që ka ndodhur në kohë ‘të padyshimta’ dhe kur nuk kishte ‘nociione paraprake’ për ‘tjetritin’. Pra një prodhim *ex novo*, krijuar nga rrethanat e imigracionit. Ndryshe qëndron puna me ‘marokanin’, një etnonim ky që lidhet për një kohë të gjatë me “përdhunuesin, fiksuar në imagjinatën kolektive popullore nga e qara e dëshpëruar e Sofia Lorenit në filmin «Çoçarja» ([«La Ciociara», Vittorio] De Sica 1960)”⁷, një pamje ende e gjallë, që jeton në kujtesën dhimbshme të veprimeve të shëmtuara të marokanëve (it. *marocchinate*).

Nëse, në vijim, zhvendosemi në kontekstin postkolonial, të paraqiturit e ‘tjetritin’ nuk duhet kërkuar edhe aq te kujtesa (koloniale) kolektive – ngaqë pjesa më e madhe e saj është fshirë ose reduktuar thjeshtë te retorika që shlyen vetveten si ajo e tipit: *Italianët, njerëz përsëmbart*⁸ – sa duhet kërkuar te stereotipët që kanë mbetur të lidhur me diskursin kolonial. Kristalizuar nga propaganda fashiste në mbështetje të retorikës (dhe si shfajsim për praktikën) ekspansioniste, këto stereotipe kanë hyrë edhe në imagjinatën kolektive italiane. Dëshmojnë për këtë reagimet kur u zgjodh ministre Cécyle Kyenge: jo vetëm sharjet raciste që i bënë por edhe qëndrimi i organeve më të rëndësishme të shtypit në lidhje me këto fyerje. Nëse këto organe nga njëra anë i përcollën fyerjet pa i censuruar – si gazeta *La Repubblica*⁹ – në të njëjtën kohë, nga ana tjetër përdorën edhe një gjuhë dhe një kujdes të sikletshëm duke e quajtur emërimin e saj si *e para ministre me ngjyrë* – shih edhe gazetën *Il Giornale*¹⁰ – “sikur fjala «e zezë» të ishte fyerje dhe i/e bardhë të ishte një i/e pangjyrshëm/-shme”¹¹. Kështu duhen interpretuar edhe polemikat e vazhdueshme rreth futbollistit ‘axurro’ Balotelli ngaqë “është italian. Dhe i zi. S’paska turp?”¹². Dukuri të këtij lloji bëjnë pjesë në debatin kompleks mbi identitetin italian, fusha semantike e të cilit përcaktohet ende nga norma somatike e bardhë, e që sjell si pasojë zhvleftësimin e ngjyrës së zezë. Pat qenë antropologu Lidio

7 Amara Lakhous, “I brutti pensieri sull’immigrazione. Tranquillizzare l’immaginario e chiarire i malintesi”, me rastin e *Va bene?! Die deutsch-italienischen Beziehungen auf dem Prüfstand* (Fachkonferenz 01.-02.12.2011 in Berlin), https://www.bpb.de/system/files/dokument_pdf/Lakhous_ITA_final.pdf, 1. Të gjitha faqet internet të cituara u konsultuan për herë të fundit më 2.06.2017.

8 Krhs. Angelo Del Boca, *Italiani, brava gente?*, Vicenza: Neri Pozza, 2005.

9 Paolo Berizzi, “Kyenge zulù: insulti razzisti sui siti della galassia nazi”, in *La Repubblica*, 30.04.2013.

10 Sergio Rame, “Chi è Cécile Kyenge, primo ministro di colore”, in *Il Giornale*, 27.03.2013.

11 Sonia Sabelli, “Quale razza? Genere, classe e colore in «Timira» e «L’ottava vibrazione»”, in *Giap – Il blog di Wu Ming Foundation*, 10.08.2013, <http://www.wumingfoundation.com/giap/?p=13861>.

12 Aldo Cazzullo, *L’Italia de noantri. Come siamo diventati tutti meridionali*, Milano: Mondadori, 2009, 81.

Cipriani “krijuesi themelor i diskursit për inferioritetin e «racës negre»”¹³ – që pastaj do të përligjte politikën kolonialiste italiane mbi baza shkencore. Këtë çështje Cipriani e vlerësoi si vijon “problemi i Afrikës së zezë dhe i zhvillimit të mundshëm të saj në përpjestim me kërkesat e kolonializimit”¹⁴: “nga të gjithë popujt, ai italian është ai që ndoshta do të përfitojë më shumë nga gjendja e natyrshme e kontinentit të zi, siç është ajo e pamundësisë së dukshme të racave indigjene për shfrytëzimin e duhur të tokave të tyre. [...] Pa ndonjë meritë tonën, e as faj, inferioriteti mendor i zezakëve, mund të jetë për ne një nga lehtësitë më të mëdha për ekspansionin tonë”¹⁵.

Tashti, nëse i vendosim përballë njëra-tjetrës parullat e përdorura nga po ajo retorikë ekspansioniste, bie menjëherë në sy veçantia diskursive e kolonializmit italian në Shqipëri. Kështu, nga njëra anë, ngaqë mungonte përsosmëria racore, me zanafillë biologjike – dhe jo kulturore apo historike siç konsiderohej në kohën liberale –, “[a]sgjë nga qytetërimi ynë nuk është me të vërtetë e rrënjësuar në Afrikën e zezë, dhe as nuk do të rrënjësohet kurrë”¹⁶, sepse do të ishte “diçka absurde njëlloj sikur dikush të mëtonte – ma falni krahasimin – të nguliste te gomarë të stërvitur mirë cilësitë e kuajve”¹⁷. Nga ana tjetër, me pushtimin ushtarak të Shqipërisë (7 prill 1939), paraqitur si ‘Bashkim politik’, “[n]ë gjindjen krenare dhe të pastër të Shqipërisë po hyn qytetërimi!”¹⁸ Pushtimi u propagandua si një mision që kishte si qëllim edukimin e gjindjes së Shqipërisë (edhe jo të racës shqiptare!) me normat e civilizimit italian, së cilës i atribuohet aftësia për t’u përmirësuar. Qysh nga fundi i shekullit XIX, brenda drejtpeshimeve të ndërlikuara të Fuqive të Mëdha, nisi të përkufizohej e ashtuquajtura *çështje shqiptare*¹⁹. Për shkaqe strategjike dhe gjeopolike, pra që të shmangej copëtimi i viseve shqiptare ndërmjet Serbisë dhe Greqisë, Italia e bashkuar (së bashku me Austrinë) kishte nisur një fushatë propagandistike që kishte si qëllim të nxirrte në pah veçantitë e papërsëritëshme të popullit shqiptar: i ndryshëm për

13 Matteo Passetti, *Storia dei fascismi in Europa*, Bologna: Archetipolibri, 2009, 131.

14 Lidio Cipriani, *Considerazioni sopra il passato e l'avvenire delle popolazioni africane*, Firenze: Bemporad, 1932, 10.

15 *Ibid.*

16 *Ivi*, 17.

17 *Ibid.*

18 Në origjinal “Tra la pura e gagliarda gente d’Albania entra la civilizzazione!” Pjesë nga komenti zanor origjinal që shoqëron pamjet e një filmi dokumentar të propagandës fashiste, tipike për kohën, e me të cilin hapet filmi *Lamerica* (1994) i regjisorit Gianni Amelio. Filmi zhvillohet në gjendjen kaotike të Shqipërisë që porsa kishte dalë nga regjimi i Enver Hoxhës dhe gjendej në mëshirë të disa afaristëve të paskrupullt italianë dhe kjo Shqipëri ëndërron Italinë sikurse italianët njëherë e një kohë Amerikën.

19 Khrr. Anselmo Lorecchio, *La questione albanese – Scritti vari*, Catanzaro: Tipografia Economica, 1898.

nga raca nga fqinjët e vet, ngaqë është indoeuropian. Shqipëria shfaqej kështu si një rrip toke i lashtë që përmbante shëmbulltyrat e vetë kulturës europiane dhe kjo e shndërronte në një diçka krejtësisht të posaçme që duhej ruajtur, dhe jo vetëm për arsye politike por edhe kulturore dhe etike. Mendimi etnografik italian në këtë drejtim – për të cilin tregojnë shënimet e udhëtimeve të Baldacci-t²⁰ përbëjnë një dokument të pasqor – diti të krijonte një stereotip pothuajse të parodizuar të burrit ‘tradicional’ shqiptar, i një indi primitiv, instinktiv, zemërak, por pikërisht për këtë arsye edhe i vërtetë, dhe i pajisur me një krenari të lashtë, me prejardhje fisnike dhe luftëtare. Prej këndeje doli edhe fjala “krenar” përdorur tek sllogani, pra, trim – virtyt italik – falë edhe së kaluarës romanike dhe të marrëdhënies shekullore, që të dyja këto mitizuar nga retorika fashiste.²¹ Por është atributi i pastërtisë²² që përfaqëson imagjinatën dhe e kthen shqiptarin në një rast *sui generis* në kontekstin postkolonial dhe në dritën e së cilës do të përpiqemi të interpretojmë në daç përfaqshen diskursive të italianëve kundrejt emergjencës së shqiptarëve – mikpritja e fillimit –, në daç *happy end*-in e një integrimi të mundimshëm e po ashtu edhe kthimin e ‘interesimit’ italian për *vendin përballë*²³.

Një faktor i mëtejshëm i veçantisë së ‘rastit shqiptar’ në kontekstin postkolonial lidhet me koordinatat kohore brenda së cilave zënë vend dhe duhen shqyrtuar, mbi të gjitha, lidhjet ndërkulturore mes dy vendeve. Bond dhe Comberati²⁴ kanë përvijuar arsyet e kësaj afërsie shumë të madhe gjuhësore dhe kulturore shprehur në të shkruarit italisht nga autorët *transkulturore*²⁵ shqiptarë. Në fakt këta duhet të konsiderohen si prodhimi

20 Shih Baldacci 1917; shih edhe *Id., L'Albania*, Roma: Istituto per l'Europa orientale, 1929.

21 Krhs. De Simonis 2013 përsa i përket rindërtimit të imazhit mjaft të imtë të paraqitjes të Shqipërisë dhe të shqiptarëve gjatë dhjetëvjeçarëve të ‘penëtrimit’ dhe të pranisë italiane në Shqipëri.

22 *La difesa della razza* – revistë e përdyjavëshme, drejtuar nga Telesio Interlandi, publikuar nga 5.08.1938 deri më 20.06.1943 –, organi kryesor i përhapjes së racizmit fashist, ku gjetën hapësirë pesë artikuj për Shqipërinë, të gjithë në 1939. Aty flitet për historinë, flitet për punët e italianëve në Shqipëri, të shqiptarëve të Italisë dhe në fund për popullin shqiptar. Shih Sandra Puccini, “Le immagini delle razze balcaniche nell’antropologia italiana tra le due guerre”, in *La Ricerca Folklorica*, 34 (1996): 59-70, këtu 68.

23 Shih filmin dokumentar të Mauro Brescia-s dhe Roland Sejkos *Albania. Il paese di fronte* (2008), që u tregon italianëve një shekull të historisë shqiptare duke u përqendruar te marrëdhëniet dykuptimshme dhe të ndryshueshme me Italinë nëpërmjet pamjeve të arkivave italiane dhe shqiptare, ndër to, shumë të pashfaqura, dhe komentet e historianëve të njohur dhe të personaliteteve të spikatura të kulturës shqiptare.

24 Shih Emma Bond/ Daniele Comberati (eds), *Il confine liquido. Rapporti letterari e interculturali fra Italia e Albania*, Nardò «LE»: Besa, 2013.

25 Shih Martha Kleinhans/ Richard Schwaderer (eds), *Transkulturelle italophone Literatur – Letteratura italo-fona transculturale*, Würzburg: Königshausen & Neumann, 2013.

dhe dëshmitarët ‘e anës tjetër’ të një historie shumëshekullore, krejtësisht të bashkëndarë dhe vetëm ‘lënë mënjanë’ në ndërgjegjën e italianëve gjatë persëdhjetë vjetëve të regjimit të Enver Hoxhës.

Në letërsinë e italo fonëve të autorëve me origjinë nga ish-kolonitë e Britit të Afrikës gjejmë, përkundrazi, të ashtuquajtuarat “kundër-rrëfime”²⁶ të një historie të “bashkë/ ndarë” (it. *con/ divisa*)²⁷, jo shekullore, por të nisur me (dhe shënuar nga) prania e kolonizatorit, “të anashkaluar”²⁸, të fshirë dhe/ ose të riformuluar në kujtesën kolektive italiane. Ky dallim themelor është i dukshëm qysh te titulli dhe te kooptinat e veprave të këtyre autorëve.²⁹ Vëmendja drejtohet – shpesh me ironi – te diskriminimi racor, te një model i italinianizmit që funksionon si përjashtim i të kundërtave, te temat e hapësirave hibride, të identiteve të racave të përzieradhe refuzimeve: me një fjalë të “efekteve të gjata në kohë për historinë e së tashmes”³⁰ të diskurseve koloniale.

Ndërsa në prodhimtarinë e autorëve shqiptarë italo fonë nuk gjejmë ndonjë referencë të tillë paratekstuale. Këtu sundon tropi i detit, ai *kufi i lëngshëm*³¹ i cili i ruan gjurmët e kalimeve shekullore, dhe vetë temën e kapërcimit të tij, të udhëtimit dhe të gjendjes së mërgimtarit që vjen si pasojë.³² Ky hendek i madh mes temave dhe diskursit i detyrohet kryesisht natyrës së ‘privilegjuar’ të kolonializmit italian në Shqipëri, por jo vetëm. Arsye të tjera – që do të meritonin një studim edhe më të thelluar – duhen kërkuar edhe tek ‘prania’ e fuqishme italiane në Shqipëri edhe gjatë

26 Franca Sinopoli, “Riferimenti identitari italiani alla luce della rilettura postcoloniale: memorie e spazi transnazionali”, in: Kleinhans/ Schwaderer 2013, 101-114, këtu 103.

27 Ivi, 102 dhe 105-106.

28 Roberto Derobertis (ed), *Fuori centro. Percorsi postcoloniali nella letteratura italiana*, Roma: Aracne, 2010, 15.

29 Krhs. Nasser Chohra, *Volevo diventare bianca* (a cura di A. Atti di Sarro), Roma: Edizioni e/o, 1993; Kossi Kombla-Ebri, *Imbarazzismi. Quotidiani imbarazzi in bianco e nero*, Milano: Marna, 2002; Gabriella Kuruvilla/ Ingy Mubiayi/ Igiaba Scego/ Laila Wadia, *Pecore nere. Racconti* (a cura di F. Capitani e E. Coen), Roma-Bari: Laterza 2005; Pap Khouma, *Noi italiani neri. Storie di ordinario razzismo*, Milano: B. C. Dalai, 2010; Igiaba Scego, *La mia casa è dove sono*, Milano: Rizzoli, 2010; Laila Wadia, *Come diventare italiani in 24 ore. Il diario di un aspirante italiana*, Siena: Barbera 2010, ose edhe Wu Ming 2/ Antar Mohamed, *Timira. Romanzo meticcio*, Torino: Einaudi, 2012.

30 Derobertis 2010, 21.

31 Shih Bond/ Comberiat 2013.

32 Krhs. Elvira Dones, *Senza bagagli* (përktheu Alma Molla; titulli origjinal *Dashuri e huaj*), Nardò <LE>: Besa, 1997 dhe *Ead., I mari ovunque* (përktheu Rovena Troque), Novara: Interlinea, 2007; Ron Kubati, *Va e non torna*, Nardò <LE>: Besa, 2000 dhe *Id., Il buio del mare*, Firenze: Giunti, 2007; Leonard Guaci, *I grandi occhi del mare*, Nardò <LE>: Besa, 2005; Drien Levani, *Solo andata grazie. I popoli degli abissi*, Modena: Alba Media, 2010; Irma Kurti, *Tra le due rive*, Patti <ME>: Kimerik, 2011, ose edhe AA.VV., *Il mare si lasciava attraversare. Antologia di scrittori albanesi sull’esodo*, Nardò <LE>: Controluce, 1997.

pesëdhjetëvjeçarit të një ‘ngrirjeje’ vetëm në pamje të parë të atij *kufiri të lëngshëm*, e cila nuk duhet kufizuar, siç ndodh, vetëm te një “videokraci italiane”³³, ajo e programeve televizive italiane që shiheshin fshehurazi për t’i ikur syrit vigjilent të regjimit³⁴. Kështu anashkalohen rregullisht, gjurmët e thella kulturore dhe gjuhësore³⁵ lënë nga italianizimi i vrullshëm zbatuar nga fashizmi, ashtu sikurse edhe shenjat e marrëdhënieve shekullore – jo vetëm ato të trashëgimisë arkeologjike dhe artistike –. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe kujtesën kolektive dhe individuale shqiptare të pushtimit italian, e cila nuk ndotet nga kujtimet e masakrave dhe të shpërnguljes në masë, por ëmbëlsohet nga nostalgjia që tregon shprehja “Ishim mirë me Italinë, jo si tani që kemi varfëri. Eh sa gjëra të mira kishim!”³⁶ dhe nga mikpritja që iu dha ‘pepinove’³⁷. “[K]ështu quhen italianët”, “të braktisur” nga lufta “në këtë vend të humbur”, ku “ndenjen duke ngrënë misërnike me *dhallë* [sic] deri në 1945”³⁸. “Ndërsa sheh ushtarët që po largohen, Saba fshin lotët dhe shaminë e zezë që ka në kokë.”³⁹ “– Të fala nënave tuaja, – i thotë Saba pepinove [në origjinal *ai peppini*] që përgatiten për të ikur. – Dhe u thoni se ju kemi dashur. Të mos mendojnë se jemi njerëz të egjër, në fund të fundit jemi fqinj [...] – Po zonjë, – i përgjigjet Toniò. – Nëse një ditë do të vini nga anët tona, shtëpitë tona janë edhe tuajat”⁴⁰. Një kujtim, në fund, i përforcuar edhe më tepër nga e gjithë filmografia patriotike shqiptare, ajo e regjimit, ende e pashqyrtuar da parte italiana, që shpeshherë e paraqet me ngjyrimë ‘të padëmshme’ prototipin e karikaturizuar të pushtuesit.⁴¹ Janë këto dëshmi që gjejmë tek kundërtregimet e autorëve transkulturalë shqiptarë dhe është kjo kujtesa që ka ushqyer ‘ëndrrën italiane’ të dyndjeve të viteve ‘90 të shekullit të kaluar.

Në vijim do të shqyrtohen marrëdhëniet italo-shqiptare duke u

33 Paolo Di Giovine, “Dal dukát all’investitór: nove secoli di italiano in Albania”, in *Treccani* (online), 15.01.2007, http://www.treccani.it/lingua_italiana/speciali/nazioni/digiovine.html.

34 Khrs. Ylli Polovina, *Rai & Albania. Una grande presenza nella storia di un popolo*, Roma: Rai Eri, 2002.

35 Khrs. Brunilda Dashi, *Italianismi nella lingua albanese*, Roma: Nuova Cultura, 2013.

36 Ornela Vorpsi, *Il paese dove non si muore mai*, Torino: Einaudi, 2005, 63. Artistja dhe autorja jeton në Paris, shkruan si në frëngjisht, ashtu dhe në italisht dhe nuk pranon, së paku deri tani, të botojë në shqip.

37 Shih Anilda Ibrahim, *Rosso come una sposa*, Torino: Einaudi, 2008/9. Shkrimtarja në fjalë ka zgjedhur italishten si gjuhën e vetme, në të cilën boton.

38 *Ivi*, 40.

39 *Ivi*, 41.

40 *Ivi*, 40.

41 Shih për shembull filmat: *Në fillim të verës* (Gëzim Erebara, 1975), *Lulëkuqet mbi mure* (Dhimitër Anagnosti, 1976), *Njeriu me top* (Viktor Gjika, 1977), *Gjeneral gramafoni* (Viktor Gjika, 1978).

përqendruar te shfaqjet dhe rishfaqjet diskursive të vështrimit italian. Më tej do t'i kushtohet vëmendjepikave kulmore të këtij frekuentimi të dendur duke nisur që nga prehistoria.

Ngjarje historike dhe diskurse pararendëse

*Adriatic brethren or black sheep?*⁴² pyeste Zinn duke nxjerrë në shesh kështu vazhdimësinë e skajshme diskursive mes mikpritjes që iu bë emigrantëve shqiptarë në Itali në mars të 1991 dhe qëndrimin e një refuzimi të ashpër vetëm pak muaj më vonë, në gusht. Megjithëse e kufizon analizën e vet tek ato ngjarje, studjuesja kapë shenjë që e dalloi ndër shekuj qasjen 'italike' ndaj dukurisë shqiptare: një "striking rhetorical shift"⁴³. E pasur në burime natyrore dhe e gjendur në një pozitë strategjike, *bregu i pestë (i Italisë)*⁴⁴ qe gjithnjë objekt i lakmive levantine të bregdetit kundruall. Interesave të kundërta gjeopolitike dhe ekonomike, i përgjigjet si rregull, simbas dobisë, kodifikimi i miteve, shprehjeve të përsëritura dhe vlerësimeve eufemistike, siç janë përmendja e rrënjëve të përbashkëta, lidhjeve historiko-kulturore ose të ndjenjave të miqësisë vëllazërore, për të shfajtuar 'ndërhyrjet' ose për të fshehur synimet e vërteta. Nga ana tjetër, në momentet kritike, të përceptuara si rrezik ose kërcënim për interesat, është përsëritur një skemë sjelljeje që ka si qëllim demonizimin e frikës, duke përcaktuar tiparet e saj, dhe duke përdorur 'tjetrin' si kokë turku. Mbi të gjitha, në çastet e kontaktit në truallin e atdheut, si pasojë e emigracioneve të bregut lindor, frikë të vjetra, e deri sindroma e një rrethimi të vërtetë, janë shoqëruar nga ndërtimi i një imagjinate armiqësore. Posë vendit të kalimeve të dykahëshme, ai rrip deti adriatikas e jonian është bërë, pra, një *kufi i lëngshëm*, që duhet të kuptohet edhe si masë e "afërsisë së largësisë"⁴⁵ – por sigurisht jo gjeografike – mes dy brigjeve. Kjo largësi, kur zvogëlohet ose kur rritet, ka kushtëzuar (dhe vijon të kushtëzojë), herë pas here, edhe cilësinë diskursive të lidhjeve.

Në prehistorinë e marrëdhënieve italo-shqiptare, dy janë çastet kulmore që ilustrojnë qasjen dikotomike që përmendëm më lart, por mbi të gjitha themelore në këndvështrimin e një diskursi të zgjatur në kohë. Mitizimi i Shqipërisë 'latine' qe, në fakt, një nga temat më të (keq)përdorura nga retorika fashiste kur mbështeste Pushtimin (1939-1943). Në Shqipërinë e sotshme

42 Dorothy Louise Zinn, "Adriatic brethren or black sheep? Migration in Italy and the Albanian crisis, 1991", in *European Urban and Regional Studies*, 3:3 (1996): 241-249.

43 *Ivi*, 241.

44 Edhe libri i Pio Bondioli-t, *Albania. Quinta sponda d'italia*, Milano: Cetim, 1939. Kështu qe zakon të quhej Mbretëria e Shqipërisë, mbasi që në vitet '30 Libinë kishin nisur ta quanin *bregu i katërt*.

45 It. *prossimità della distanza*, Bond/ Comberiat 2013, 7.

janë ende të dukshme gjurmët romake, fryt i pesë shekujve sundimi romak (nga 167 p. K.). Ndikimi i Romës nuk u kufizua vetëm me ngritjen e shumë kolonive, me ndërtimin e infrastrukturës madhështore ose me organizimin territorial. *Dyrrachium* (Durrësi i sotëm) dhe *Apollonia* qenë, përveç se baza të rëndësishme për tregtinë dhe për veprimet luftarake – mjafton të kujtojmë këtu ngjarjet e luftës civile ndërmjet Cezarit dhe Pompeut –, edhe qendra kulturore. Oktaviani, për shembull, “Apolloniam studiis vacavit” (Svetoni, *De vita Caesarum*, II, 8, 2)⁴⁶. Rruga Egnacia (*Via Aegnatia*)⁴⁷ (130 p. K.), një etapë e detyrueshme e rrugëtimit drejt lindjes, ngaqë ishte pjesë e një rrjeti rrugor të fuqishëm, qe shtegu nga u përshkuan dendur sundimtarët, gjë që krijoi edhe kushtet për përhapjen e Krishtërit dhe kushtëzoi ndjeshëm gjuhën⁴⁸ e ilirëve. Në këtë fazë themelore të kontakteve, përceptimi ‘i tjetrit’ nuk qe aspak i njëtrajtshëm. Përkundrazi ndoqi një rrugë që do të përsëritej në thelbin e diskursit përgjatë historisë. Fillimisht ‘çështja ilire’ ishte thjeshtë rreziku që përbënte për rrugët detare të tregtisë “ἀπ’ Ἰταλίας” (Polibi, *Ἱστορίαι*, II, 8, 3). Sipas Polibit, fillimisht romakët nuk i kushtuan fort vëmendje faktit se kush po hidhte akuza kundër ilirëve (po aty, II, 8, 1), e pra, qëndrimi i tyre u kushtëzua shumë nga përçmimi i vjetër që grekët kishin për një popull që sundohej nga mbretër pijanecë, që merreshin me plaçkitje; një popull i paaftë për të krijuar një politikë të jashtme dhe që nuk dinte të respektonte “τῶν παρ’ ἀνθρώποις ὠρισμένων δικαίων” (po aty, II, 8, 12). Ngjarjet e Teutës – mbretëreshës ilire fodulle, inatçore dhe të pabesë, e cila i ngriti një kurth shpurës romake (po aty, II, 8) – formoi një *topos* që i vuri vulën imazhit të një gjindeje fodulle, mizore, kryeneçe, por mbi të gjitha pa sistem drejtësie dhe pa sistem politik të zhvilluar, gjë që nuk mund të mos i indinjonte përfaqësuesit e atdheut të së drejtës. Në këtë këndështrim diskursiv duhen parë tonet që përdor Plauti kur i përkufizon banorët e Durrësit – pagëzuar rishtazi si “Hadriae tabernam” nga Katuli (*Carmina*, 36, 15)⁴⁹ – një turmë, mashtruesish, qylxhinjsh, pijanecësh dhe prostitutash (Plauti, *Menaechmi*, Akti II). Plauti luan edhe me një etimologji të rreme të emrit të vjetër të këtij qyteti: “propterea huic urbi nomen Epidamno inditumst, quia nemo ferme huc sine damno devortitur” (po aty). Qysh në shek. I p.K., për shkrimtarët latinë, sidoqoftë ishte shlyer vetë nocioni i popullit

46 Citimet e autorëve grekë dhe latinë janë marrë nga *Perseus Digital Library*, <http://www.perseus.tufts.edu/hopper/>.

47 Kjo lidhte *Dyrrachium* me *Byzantium* si një vazhdim i natyrshëm i rrugës *Via Appia* e cila shkonte nga Roma në *Brundisium*.

48 Gjuha shqipe sadoqë ruan një autonomi të vetën në kuadrin e gjuhëve indoeuropiane, është ndikuar shumë nga kontributi latin, mbi të gjitha, leksiku i saj. Shih Carlo Tagliavini, *L'origine delle lingue neolatine. Introduzione alla lingua romanza*, Bologna: Pàtron, 1982, 13.

49 Por që vihet në pah nga Ciceroni: “et libera civitas est et in me officiosa et proxima Italiae” (*Epistulae ad familiares*, 14, 1, 7), ndoshta ngaqë e kishte mikpritur.

ilir, si pasojë e shtypjes së fuqishme e cila kishte thyer kryengritjen e fundit. Përkundrazi, në periudhën e Augustit, ishte e dobishme të krijohesh një mit që do të hidhte themelet e një lidhjeje epike. Virgjili do t'i pohonte këto lidhje me të kaluarën (*Aeneis*, III, 291-505) të vargjet ku i zbulon Eneut, pikërisht në territorin e sotëm shqiptar, një qytet të ngritur nga trojanët e shpërngulur, një *Ἰλιον* epirotase, Butrintin e sotëm⁵⁰. Me një aludim të padeshifrueshëm, heroi i lidh pasardhësit e vet, banorët e ardhshëm të *Ἰλιον* italik të cilin do ta themelonte pak më vonë në *Esperia*, për të ruajtur impenjimin për “unam faciemus utramque Troiam animis” (po aty, 505), ngaqë këto ishin të lidhura nga gjaku. Regjimi fashist, mbasi e kishte themeluar mitin e vet tek kujtesa e Romës perandorake, mori me bollëk nga trashëgimia arkeologjike, duke krijuar për synime propagandistike ‘vende kujtese’ në Shqipërinë fashiste. Në këtë këndvështrim rindërtimi ose ‘kolonizimi’ të imagjinatës hyn edhe organizimi i një Udhëtimit virgjilian me anije (15.09.1930) për të shkuar e për të parë rrënojat e Butrintit, sikurse edhe nxjerrja e pullës postare⁵¹ që paraqet Helenin teksa përshëndet Eneun me krahun e djathtë, me përshëndetjen tipike romake dhe duke i parathënë – kështu lexohet tek dëçitura – mbërritjen në Auzoni, domethënë në Itali, “mbasi që kishte përforcuar lidhjet e pazgjidhshme ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut.”⁵²

Nëse sundimi romak përbën një rast pararendës historik që shpreh shtytjen ekspansioniste që nuk u shua kurrë nga perëndimi drejt lindjes, shpërngulja e arbërve drejt brigjeve italiane, të shtyrë nga përparimi i osmanëve, e që u bë tepër i madh duke nisur nga gjysma e dytë e shek. XV, përbën, përkundrazi, kulmin e një prirjeje emigrimi – po aq e njëtrajtëshme – në kahun e kundërt. Bëhej fjalë për një emigracion historik, një hemorragji

50 Legjenda tregon se Heleni, i biri i Priamit, pas martesës me Andromakën, vejushën e Hektorit, do të themelonte një Trojë të re, *Buthrotum*. Përkundrazi, me shumë mundësi qenë grekët (shek. VI p. K.) ata që e kolonizuan *Βούτρος*. Shih Micunco 1995, 47.

51 Emetuar më 21 tetor 1930. Gjendet në rrjet, http://wiki.ibolli.it/wiki/images/c/c3/Filo_virg_15.jpg.

52 Kështu lajmëroi për emetimin e kësaj pulle Gazeta Zyrtare e Mbretërisë së Italisë (1-IV-1931-IX – N. 75, 1479-1480). Khros. Olimpia Gargano, “La colonizzazione dell’immagine: l’Albania <latina> nell’Italia del primo Novecento”, in *Iconocrazia – Cartoline Interadriatiche*, 5 (2014): <http://www.iconocrazia.it/la-colonizzazione-dellimmagine-lalbania-latina-nellitalia-del-primo-novecento/>, përsa i përket një hetimi më të thellë të mitizimit të latinizimit të shqiptarëve nga ana e fashizmit. Përveç tjerash, kjo ide u pat shprehur me tërë forcën e vet edhe nga Ministri i Punëve të Jashtme të Italisë Galeazzo Ciano, në fjalimin çelës të Asamblesë së parë plenare të Dhomës së Fashove dhe të Korporacioneve, më 15 prill 1939-XVII, me rastin e diskutimit dhe të miratimit përmes brohoritjesh të projektligjit “Pranimi i kurorës së Shqipërisë nga ana e Mbretit të Italisë, Perandor i Etiopisë”. Shih relacionin stenografik që gjendet në rrjet, <http://storia.camera.it/regno/lavori/leg30/sed001.pdf>.

njerëzore (për afro 200.000 vetë)⁵³. Këta qenë mërgimtarë të dëshpëruar e kjo histori do të përsëritej rishtas në vitet '90 të shekullit të kaluar, jo vetëm në shifra por edhe në paradigmën diskursive të përfuturit: në fillim mikpritje, pastaj armiqësi dhe refuzim, dhe në fund, integrim i suksesshëm. Kështu u pati përshkruar Papa Pali II (me gjasë në 1468): "Albanenses partim caesi gladio sunt, partim in miseram servitutem abducti; [...] vicinae gentes, quae Adriaticum mare attingunt, propinquo metu exterritae, tremunt [...]. Audire miserum est, quanta omnium rerum sit conturbatio, lacrymabile inspicere navigia fugiendum, ad Italos portus appellere, familias quoque egentes pulsas sedibus suis passim sedere per littora, manusque in caelum tendentes, lamentationibus suis cuncta implere."⁵⁴ Këto tone empatike, e që shprehin solidaritet, duhen interpretuar edhe në dritën e ngjarjeve të asaj kohe në ballin e luftës dhe të rrezikut osman. Luftëtari Skënderbe – monumenti i të cilit u pat ngritur nga Benito Mussolini në 1940 në Sheshin Albania, në Romë –, i mbështetur edhe nga *Serenissima*, nga Shteti Papnor dhe nga Mbretëria e Napolit, ia kishte dalë të lidhte fisnikët arbër në luftë kundra turkut dhe të ndalonte përparimin e osmanëve drejt Europës. U quajt *athleta Christi* dhe miti i heroizmit të popullit arbëror u fut vrullshëm në imagjinatën europiane.⁵⁵ Krahas pritjes së ngrohtë që iu dha Kisha, emigrimi i arbërve ishte nxitur edhe nga Mbretëria e jugut, ngaqë kështu populloheshin rishtas të ashtuquajturat *terrae vacuae* – territore të gjëra që ishin shpopulluar nga humbjet e mëdha shkaktuar nga luftrat mes feudalëve ose nga epidemitë – dhe për të ndihmuar në rimëkëmbjen e bujqësisë në këto treva. Përkundrazi, përta i përket bashkëjetesës së përditshme të të ardhurve – të quajtur *arbëreshë* – me popullatën vendase, bie në sy fakti që këta të fundit nuk i duronin dot, aq sa shpërthyen edhe në qëndrime armiqësore kundër arbëreshëve. Këta i kishin damkosur si "rixosi, inquieti, mendaces et proditores, sommamente nocivi per i vicini"⁵⁶ dhe akuzoheshin për lloj-lloj krimesh. Puna shkoi deri aty sa të kërkohej,

53 Rigels Halili, "Uno sguardo all'altra sponda dell'Adriatico: Italia e Albania", in: Bond/Comberiat 2013, 31-71, këtu 40.

54 Dorëshkrimi përfshihet te burimet me disa variante të vogla. Krhs., mes tjerash, <http://www.jemi.it/storia/arberia/storia/sp-813/manoscritto-inedito-del-papas-andrea-figlia-1764>, ose Francescoantonio Vitale, *Memorie Istoriche degli Uomini illustri della Regia Città di Ariano*, Roma: Stamperia Salomoniana, 1788, 27.

55 Duhet përmendur, po ashtu, edhe vlerësimi si ky që vijon: "Nuy non si fidano di lui per niente, perché è Albanese et è traditore et è tristo" (Paola Lisimberti/ Antonio Todisco, *Puglia e Albania – Introduzione allo studio delle relazioni adriatiche. Per una teoria della convivenza*, Fasano di Brindisi: Schena, 1992, 52), shprehur nga këshilltari i Dogjës në një relacion të 1464. Ky relacion shfaq edhe shenjat e një vlerësimi të dyzuar të marrëdhënieve venediko-arbërore, shkaktuar nga përplasjet dhe mëtimet e Venedikut për prona të tëra në territorin arbëror.

56 Ivi, 108.

në disa raste, që arbëreshët të banonin “vetëm në qyteza të rrethuara me mure, mos të mbanin armë dhe mos të mbanin kuaj apo mushq”⁵⁷, e madje arritën deri aty sa t’i akuzonin si përhapës të murtajes⁵⁸. Moskuptimi i gjuhëve dhe i zakoneve përkatëse, e sidomos mospërkimi ndërmjet besimit latin dhe atij ortodoks, lakmia që ngjallën sukseset e arbëreshëve në fushën e pemëtarisë dhe të bujqësisë, smira për privilegjet, ndihmat ose lehtësime i taksave për ta që iu njihnin sovranët ose fisnikët vendas, kujtesa e frikës së dikurshme të lidhur me kontaktet pararendëse me luftëtarët ballkanikë që kishin emër të keq, me *stradiotët* – “njerëz kafshëror”⁵⁹ –, u shoqëruan nga një imagjinatë kolektive e keqe e cila mbijeton ende sot e kësaj dite në dialektet jugore, në formë shprehjesh popullore⁶⁰.

Bashkësitë arbëreshe ende sot e ruajnë gjuhën e tyre, arbërishten, dhe kanë ditur t’i ruajnë doket dhe zakonet e veta. Asnjëherë nuk arrit në atë pikë sa të imponohet asimilimi me dhunë; përkundrazi, ruajtja e identitetit të tyre dhe e një atmosfere bashkëjetese paqësore, kur në horizont u shfaq ‘çështja shqiptare’, doli se ishte mjaft e dobishme. Shqiptarët e Italisë u përdorën (madje edhe u veshën ushtarë) për të përligjur mëtimet italiane ndaj Shqipërisë.⁶¹ Kështu që nuk çudit fakti se Francesco Crispi, arbëresh, një nga figurat më të spikatura të Rilindjes italiane dhe promovues i ekspansionit kolonialist të shkruante një artikull botuar në Palermo, në maj të 1900: “Marrëdhëniet e miqësisë së përzemërt dhe të thellë, kultivuar për më shumë se pesë shekuj, e vendosin [Shqipërinë] shumë më afër nesh sesa me perandorinë austriake.”⁶² Më vonë në shkollat e hapura nga Mbretëria e Italisë në trevat e Shqipërisë që kishte pushtuar – “në 1918 ishin hapur 155 shkolla fillore”⁶³ –, përta i përket mësuesve italianë, “kur kishte mundësi, zgjidheshin italo-shqiptarë nga Italia e jugut, të cilët në shkollë flitnin edhe shqip. Të zgjedhurit e mësuesve vendas që punë më e vështirë: u zgjedhën më të mirët dhe u krijuan për ta kurse magjistrale të përsheptuara pranë Kolegjit arbëresh të Shën Demetër Korones”⁶⁴. Në perspektivën afatgjatë, në fund mandej, emra të njohur me origjinë shqiptare të dukshme si për shembull Papa Klementi XI (Giovanni Francesco Albani), Tito Schipa,

57 *Ibid.*

58 *Ibid.*

59 Paolo Petta, *Stradioti. Soldati albanesi in Italia (sec. XV-XVX)*, Lecce: Argo, 1996, 58.

60 Krhs, për shembull, proverbin paralajmëruet kalabrez: “Nëse të pret rrugën shqiptari dhe ujku, bjeri në fillim shqiptarit e më pas ujkut.” (*Quannu vidi u ghjeghju e u lupu, spara prima u ghjeghju e pu u lupu*), http://www.arbitalia.it/news/mazziotti/2009/eparchia_lungro_speciale_90_anni.htm.

61 Shih Halili 2013, 40-46.

62 *Ivi*, 44.

63 Baldacci 1929, 293.

64 *Ibid.*

Antonio Gramshi, Costantino Mortati, Enrico Cuccia, Stefano Rodotà, por edhe Carmine Abate dhe Ana Oxa, dëshmojnë për përfundimin pozitiv të një udhëtimi diakronik-diskursiv krejtësisht të përvetësueshëm, siç do ta shohim pastaj, nga valët më të fundit të emigracionit shqiptar në Itali.

Neoitalianët e Shqipërisë dhe neoshqiptarët e Italisë

Sot, aksiomën *shqiptar = kriminel*⁶⁵ në faqet e të përditshmeve italiane e kanë zëvendësuar shenjestrat e tjera 'etnike'. Ka ndërgjegjësim se kriminaliteti shqiptar lidhet vetëm me bandat, jo me individët: "[n]jë kolektivitet me kriminelë dhe jo një kolektivitet kriminelësh"⁶⁶. Kjo bashkësi imigrantësh, e cila mban rekordin përse i përket denigrimit që edhe sot e kësaj dite nuk ka të krahasuar – "Yet they are the nationality most rejected and stigmatized by Italians: stereotyped as criminals, prostitutes and uncivilized people"⁶⁷ –, vijoi të lidhej me imazhin mbresëlënëse fillestar të *boat people* në Mesdhe e gjithë Europën, deri atëherë kur nisi kriza e refugjatëve në Lampeduzë. Po kjo bashkësi, ka arritur sot të gëzojë një konsideratë të tillë që deri para pak vitesh nuk mund të merrej dot me mend. Por nuk mbaron me kaq.

Gjendemi këtu përpara një 'ndryshim kursi' në vështrimin e plotë të fjalës – sa për të qëndruar brenda fushës semantike të *kufirit të lëngshëm* –: *Emigrantët, tashti, jemi ne*⁶⁸. Nga ana tjetër e detit prania e italianëve sa vjen e shtohet, "Shqipëria po bëhet krahina e 21 e Italisë"⁶⁹. Janë 19.000, sipas të dhënave zyrtare⁷⁰, por ndoshta edhe dyfishi, sipërmarrës të vegjël e të mëdhenj, mjekë, kuzhinierë, avokatë, arkitektë, punëtorë, hidraulikë, saldatorë, studentë... operatorë të call centre-ave, ose thjeshtë, njerëz të zhgënjyer nga Italia që janë shpërngulur në Shqipëri – aty ku nuk ka as

65 Shih Alessandro Silj, "«Albanese = criminale». Analisi critica di uno stereotipo", in *Limes*, 2 (2001): 247-261.

66 Franco Pittau/ Antonio Ricci, "Gli albanesi e il superamento di cinque miti sull'immigrazione. Una rilettura di 20 anni di immigrazione dal Paese delle Aquile", fjala e mbajtur me rastin e *Settimana della cultura albanese*, organizuar nga Illyricum, Patronato Acli, Acli dhe Ipsia – Milano 3.12.2010, <http://immigrazioneoggi.it/contributi/documenti/Albania-Milano-3dic2010.pdf>, 6; botuar dhe në *Studi Emigrazione*, 181 (2011): 137-150.

67 Russel King/ Nicola Mai, "Italophilia meets Albanophobia: paradoxes of asymmetric assimilation and identity processes among Albanian immigrants in Italy", in *Ethnic and Racial Studies*, vol. 32, 1 (2009): 117-138, këtu 117; botuar në rrjet më 27.11.2008.

68 Paolo Berizzi, "Italiani d'Albania: I migranti ora siamo noi", in *La Repubblica*, 1.11.2013.

69 *Ibid.*

70 Shih "Albania: ora sono gli italiani a cercare lavoro lì" (pa autor), in *Lavorare all'Estero*, 9.09.2015, <http://notizie.lavorareallestero.it/albania-ora-sono-gli-italiani-a-cercare-lavoro-li/>.

nevojë të mësosh gjuhën shqipe!⁷¹ –, për të ndërtuar një jetë më të mirë. Shtypi italian i përkufizon njëzëri *italianët e Shqipërisë* (ndër të tjerë, *La Repubblica, Corriere della Sera, La Stampa*)⁷². Kjo dukuri shoqërohet dhe përcjell tonet e një fushate propagandistike: *Sa cool është Tirana!* – titulli i një artikulli të revistës *L'Espresso*⁷³. Kemi të bëjmë me një *dejà vu*? Megjithatë, tregohet kujdes që të mos flitet për 'kolonë të rinj'. Lista e artikujve, reportazheve, dokumentarëve, reportazheve të posaçme, intervistave që flasin për këtë temë është e gjatë. Një i ftuar i gjithëpranishëm⁷⁴, ekspert në këtë fushë, është edhe gazetari shqiptar – me pasaportë italiane –, Leonard Berbéri, mishërimi shembullor i një integrimi, duke filluar nga zbarkimi në Pulje e deri tek puna në redaksinë e gazetës *Corriere della Sera*. Ndërkaq, në rrjetet sociale po bën namin fenomeni *Lambrenedetto XVI*⁷⁵, pseudonim i Lorenzo Lambrughit, një «Internet meme», mjaft i ndjekur, i shikuar dhe i diskutuar⁷⁶, që është një zëdhënës i ndjenjave filoshqiptare deri në kufi të fanatizmit. Videot amatoriale⁷⁷ të bëra nga ky, dhe të hedhura në rrjet, ngrejnë në qiell saktësinë, leverdinë dhe dashamirësinë për Shqipërinë e Re. Meriton vëmendje, në fund, një seri nga më të fundit të programit *Agorà*⁷⁸, ngaqë na paraqet një pamje më aktuale të evolucionit, edhe atij diskursiv, të marrëdhënieve italo-shqiptare. I ftuar (i posaçëm) për të shprehur pikëpamjen e tij për problemin e emergjencës më të fundit të emigracionit, dhe për të përcjellur të dhëna – mjaft entuziazmuese – më të freskëta për shqiptarët e Italisë dhe italianët e Shqipërisë, Edi Rama u prit si “i ftuar i jashtëzakonshëm, kryeministër i Shqipërisë! [duartrokitje të nxehta]”⁷⁹.

71 Shih Sveva Sagramola (drejtuese), *Geo* (programi i Rai 3), 25.03.2015, <http://www.rai.it/dl/portaleRadio/media/ContentItem-172803ff-e3c3-4e39-9ac9-9cbb91517056.html#>.

72 Shih, midis të tjerëve, Berizzi 2013; Leonard Berbéri, “Noi, gli italiani d’Albania” (reportage), in *Corriere della Sera*, 2014, <http://www.corriere.it/reportage/esteri/2014/noi-gli-italiani-dalbania/>; Niccolò Zancan, “Italiani d’Albania. Migrare a Est in fuga dalla crisi”, in *La Stampa*, 17.10.2014.

73 Alessandro Gandolfi, “Com’è cool Tirana, simbolo della nuova Albania”, in *L'Espresso*, 2.03.2015.

74 Shih, midis tv tjerve, Benedetta Rinaldi (drejtuese), *Community – L'altra Italia* (programi i Rai-t, kushtuar italianëve që jetojnë jashtë shtetit), 18.11.2014, <http://www.rai.tv/dl/RaiTV/programmi/media/ContentItem-520815eb-b043-4d60-80bb-c3c263836ac7.html>, edhe Sagramola 2015.

75 Krhs. kanal in *Facebook*: <https://www.facebook.com/LambrenedettoXVI/>.

76 Cristiano Bosco, “Lambrenedetto» e l’abisso tra Germania e Italia”, in *Linkiesta*, 19.10.2013.

77 Khrs. p.sh. dhe https://www.youtube.com/watch?v=fwCX_oOgOo8.

78 Shih Andrea Vianello (drejtues), *Agorà* (Rai 3), 20.7.2015, <http://www.rai.tv/dl/RaiTV/programmi/media/ContentItem-33f06db1-2074-4a08-aa6e-a9dca4d56fae.html>.

79 *Ibid.* Tonet – por sigurisht jo klima dhe synimi politik – duken sikur përsërisin “Përshëndetjen drejtuar delegacionit shqiptar” të Kryetarit Costanzo Ciano gjatë

Ai deklaroi se paragjykimet për shqiptarët janë kapërcyer përfundimisht dhe koha dhe historia kanë ndryshuar në një mënyrë të paimagjinueshme. Po ashtu, paralajmëron, duke e hedhur fjalën për burgun e mendjes (diskriminimin) e italianëve, se “një vend i cili ka përjetuar emigracionin në kurriz të vet nuk mund t’ia lejojë vetes të shkojë përtej asaj çka është e arsyeshme”⁸⁰.

Të tjera fakte nga jeta shoqërore dëshmojnë në daç për asimilimin me sukses dhe fitimtar të shqiptarëve, në daç për një mënyrë tjetër të menduarit të formuar nga ana italiane. Tashmë shihet si diçka e natyrshme, për shembull, pjesëmarrja – dhe shpesh fitorja – e artistëve shqiptarë në programet *talent show* dhe në *kermesse-t*, në nivel (katërcipërisht) kombëtar, më të ndjekura (*Amici* – Canale 5, *The Voice of Italy* – Rai 2, *Sanremo* – Rai 1 në Eurovizion), në ndeshjet miqësore të futbollit dy flamujt valëviten krahas njëri-tjetrit dhe himni i Mamelit “këndohet nga i tërë stadiumi”⁸¹, shkrimtarët shqiptarë italoфонë botojnë në shtëpitë botuese italiane më të njohura dhe shpesh zgjedhin italishten si gjuhë (ekskluzive) letrare, edhe atëherë kur nuk jetojnë më në Itali. Ka mandej një brez të dytë, rritur nga pikëpamja shoqërore në Itali dhe formuar (edhe) sipas modeleve diskursive italiane. E dëshmon këtë *Memories of a ruined Summer*⁸², vepra e debutimit e Kacit, në italisht, e cila tregon për pushime të përjetuara si ekzil përdhuni në vendlindje, një vend që nuk e ndjen më si të vetin, vite dritë larg nga qytetërimi siç e kupton ai.

Që në 2008, gazeta *Corriere della Sera* botoi një artikull me titull *Neoshqiptarët e Italisë* «*Tashti nuk të fusin më frikën*»⁸³, duke deklaruar se vala e parë e emigrantëve ishte “bluar dhe tretur”⁸⁴ dhe se ishte groposur një herë e mirë armiqësia kundrejt shqiptarëve, të parë (shtrembër) për afro njëzet vjet si “prototip i imigrantëve «të këqinj dhe të dhunshëm»”⁸⁵, me një fjalë, persona të padëshirueshëm. Ky pohim mbështetet në të dhëna statistikore të punësimit, familjen, arsimin dhe çështjet e drejtësisë në kuadër të një

Asamblesë së parë Plenare të Dhomës së Fashovë dhe të Korporacioneve – 15 prill 1939-XVII: “Jam i lumtur dhe krenar që po i sjell përshëndetjen e kësaj Asambleje përfaqësuesve të Kombit fisnik dhe trim [it. *nobile e valorosa Nazione*] shqiptar! (*brohoritje të shumta*). [...] Rroftë Shqipëria! Rroftë Italia! (*brohoritje të zgjatura*)”. Shih relacionin stenografik në rrjet: <http://storia.camera.it/regno/lavori/leg30/sed001.pdf>.

80 *Ibid.*

81 Valerio Arrichiello, “L’Italia al Ferraris, tifosi albanesi in delirio fuori dallo stadio”, in *Il Secolo XIX*, 18.11.2014.

82 Shih Gabriele Gëzim Kaci, *Memories of a ruined summer*, L’Erudita, 2013.

83 M. Antonietta Calabrò, “I nuovi albanesi d’Italia «Ora non fanno più paura»”, in *Corriere della Sera*, 8.10.2008.

84 *Ibid.*

85 *Ibid.*

kërkimi zbatuar nga Caritas/Migrantes⁸⁶. Nëse shifrat flisnin për një *'best practice'* të integritit dhe zhvillimit⁸⁷ të shqiptarëve në Itali, studimi i përmendur më lart i po asaj kohe (2009) tërhiqte vëmendjen për "Albanian assimilation paradox"⁸⁸ në kontekstin e takimit-përplasjes (asokohe) në zhvillim e sipër ndërmjet *Italophilia* dhe *Albanophobia*, duke nënvizuar asimetrinë ndërmjet integracionit të suksesshëm dhe damkosjes ende të dukshme dhe, duke u mbështetur tek intervista të shumta të emigrantëve shqiptarë, "the multifaced dimensions of their patchy assimilation"⁸⁹. Nga ana tjetër, vetëm pak vite më parë, përfundimet e kërkimeve në rang kombëtar⁹⁰ flisnin – me gjithë veçoritë në rang krahinor – për vijimin e mosbesimit kundrejt emigrantëve shqiptarëve "që përceptohej nga opinioni publik si më i largti, më pak i pranueshmi, më i damkosuri"⁹¹, "periferik, me shumë mundësi i devijueshëm"⁹². Niveli i punësimit paraqitej i mirë, i cili "sidoqoftë përdor rrugë të tjera jo zyrtare dhe informale, mbështetet tek një rrjet me vizibilitet të ulët, dhe që e përdor mimetizimin në shoqëri si strategji të fitores të padukshme."⁹³ Përsa i përket integritit shoqëror flitej për një "përfshirje të nënvarur"⁹⁴ si alternativë e refuzimit.

Duke shkuar akoma më prapa në kohë për dukurinë e pranimit të emigracionit shqiptar, duhet të shikojmë pamjet tronditëse të ngulitura në kujtesën kolektive italiane të 8 gushtit 1991: ankorimin në portin e Barit të *Asaj* *«anijes së ëmbël»*⁹⁵ dhe të *mallkuar*⁹⁶, e mbushur plot e përplot (më

86 Në kuadrin e programit të afërsisë Interreg-Cards *Aquifalc – l'aquila e il falcone volano insieme* (2007-2008), ekipi i Dosjes Statistike të Emigracionit *Caritas/Migrantes* u mor me kërkimin "Integrazione e impatto economico degli albanesi in Italia". Krhs. Rando Devole/ Franco Pittau/ Antonio Ricci/ Giuliana Urso (eds), *Gli albanesi in Italia. Conseguenze economiche e sociali dell'immigrazione*, Roma: Idos, 2008; khrs. dhe Pittau/ Ricci 2010.

87 Shih Franco Pittau/ Antonio Ricci/ Giuliana Urso, "Gli albanesi in Italia: un caso di «best practice» di integrazione e sviluppo", in *Revista Interdisciplinar da Mobilidade Humana*, anno XVII, 33 (luglio/dicembre 2009): 153-173.

88 King/ Mai 2009, 117.

89 *Ibid.*

90 Shih Ugo Melchionda (ed), *Gli albanesi in Italia. Inserimento lavorativo e sociale*, Milano: Franco Angeli, 2003.

91 *Ivi*, 15.

92 *Ivi*, 11.

93 *Ibid.*

94 *Ivi*, 16.

95 Bëhej fjalë për anijen tregtare *Vlora*, drejt së cilës u turrën emigrantët në Durrës dhe që ishte e ngarkuar me tonelata sheqeri. Prej këndej doli edhe titulli i filmit dokumentar i regjisorit Daniele Vicari-n, *La nave dolce (Anija e ëmbël)* (2012). Filmi flet për ngjarjet që shoqëruan atë zbarkim dramatik duke përfshirë edhe kujtimet e të pranishëmve në atë anije.

96 Shih Claudia Morgoglione, "Quella «Nave dolce» e maledetta. Volti e storie di un dramma

shumë se 20 mijë) me të ikur nga Shqipëria postkomuniste tashmë në gjunjë dhe skenat e të 'mbyllurve' në stadiumin *Vittoria*. Këto pamje zgjonin në kujtesë "ngjarje tragjike në vende si Kili i Pinoçetit"⁹⁷. Ato ngjarje (dhe riatdhesimi i detyruar) shënuan një prerje të marrëdhënieve italo-shqiptare dhe "një plagë të thellë që capërloi jo vetëm ata që e pësuan por edhe ne. Kjo, sepse për vendin tonë kjo qe humbja përfundimtare e pafajshmërisë kundrejt emergjencës së emigracionit që nuk ka përfunduar ende qysh atëherë."⁹⁸ Mbasi e kishte mbyllur lojën si vendi më i madh eksportues i emigrantëve, para vetëm dy dhjetëvjeçarëve dhe e bindur se kishte arritur me mundim një drejtëpeshim të brendshëm, Italia e përceptoi atë dyndje dhe ato që vijuan si një shpërngulje biblike, një *Hordhi*⁹⁹, një dukuri që të shtinte ndërmend, veçanërisht përsa i përket paragjykimeve dhe trajtimit të të shpërgulurve, emigracionin historik italian të kohës, sipas Stella-s, *Kur shqiptarët ishim ne*, që mesa dukej ishte fshirë nga kujtesa e italianëve. Ngjarjet e 1991-it e vendosën Italinë krejt papritur përballë një realiteti, i cili e gjeti të papërgatitur. Italia ishte kthyer në pikëmbërritjen e dyndjeve të mëdha. Kështu mund të shpjegohen edhe këto njëzet vjet në gjendje alarmi obsesiv i cili ushqehet dhe shumëfishohet¹⁰⁰ nga bombardimi diskursiv i mjeteve të informacioneve dhe të institucioneve¹⁰¹. Kjo gjë çoi në damkosjen e shqiptarëve si shkaktarë të murtajes, pra, të kësaj situatë jashtë kontrolli (ose të përjetuar si të tillë).

Përveç se në satirën italiane – "Italia është një gadishull i lagur nga shqiptarët"¹⁰² –, këtë atmosferë sunduese, shenjuar nga 'gjuetia e infektuesve të murtajes', e gjejmë edhe tek vepra e njërit prej përfaqësuesve më të mëdhenj të *letërsisë italofone transkulturore*¹⁰³. Kjo është një letërsi e shkrimtarëve që quhen ndryshe edhe 'migrantë', e në të njëjtën kohë edhe objekt, dëshmitarë dhe interpretues të qëndrimit italian kundrejt alteritetit. Bëhet fjalë për Amara Lakhous-in, shkrimtar, antropolog dhe

dimenticato", in *La Repubblica*, 7.08.2012.

97 *Ibid.*

98 *Ibid.*

99 Shih Gian Antonio Stella, *L'Orda. Quando gli albanesi eravamo noi*, Milano: Rizzoli, 2002.

100 Për fushatën e reklamimit të modeleve vjeshtë/dimër 1991/92, Benetton-i pati zgjedhur pamjet e anijes Vlorë plot me ikanakë. Shih http://www.gianfrancomarrone.it/ildiscorsodimarca/wp-content/uploads/2007/10/benetton_albanesi.jpg.

101 Flet qartë për këtë deklaratë: "Hidhini në det që t'u vijnë mendtë" që bëri më 27.04.1997 Irene Pivetti, ish kryetare e Dhomës së Deputetëve, në prag të tragjedisë së motovedetës shqiptare *Katër i radës*, e cila u godit nga anija e Marinës luftarake italiane *Sibilla*, që shkaktoi 108 të mbytur. Shih Giovanni Maria Bellu, "Il naufragio degli albanesi e la giornalista Pivetti", in *La Repubblica*, 1.04.2007.

102 Gino & Michele/ Matteo Molinari, *Anche le formiche nel loro piccolo si incazzano. Anno secondo*, Milano: Baldini & Castoldi, 1992, 31.

103 Shih Kleihans/ Schwaderer 2013.

gazetar “algerian me shtetësi italiane [sic]” (Wikipedia), i cili me qëllim “çmitizimin e kulturor”¹⁰⁴ krijon personazhe “të tejngarkuara me imazhe të ndryshme shoqërore”¹⁰⁵, të cilat janë zbatimëse pikërisht ngaqë pasqyrojnë atë “imagjinatë kolektive që ushqehet nga përdorimi sipërfaqësor dhe imoral i mjeteve të shtypit, gjë e cila ofron mundësi për mendime të thjeshtëzuara dhe që bëhet burim i thjeshtëzimit të identiteteve <të tjera> [it. *identità <altre>*].”¹⁰⁶ Te libri *Përplasje qytetërimesh për një ashensor në Sheshin Vittorio*¹⁰⁷, derëtarja napoletane dyshon tek emigranti iranian Parviz për krimin që porsa është kryer. Sipas logjikës tipike të mendësisë së saj, që pasqyron saktësisht atë të zakonshmen, “ai shqiptari [dial. *chillo albanese*; e ka fjalën për emigrantin iranian] është vrasësi i vërtetë.”¹⁰⁸

Vetë realiteti kriminalizues është marrë si temë, natyrisht, nga autorët shqiptarë italoфонë, por rrallëherë me tone denoncuese. Më të shumtën pasqyrohet në formën e një rrëfimi të drejtpërdrejtë të një fakti të mirëqënë ose të disa syresh. I tillë është *Nipërit e Skenderbeut*¹⁰⁹ i Spanjollit që i rrëfen ato ditë të gushtit 1991 nga brendë. Shpeshherë kundërtregimi i vështrimit të hedhur mbi popullin mikpritës merr formën e një ‘komenti anësor’, pra duke mos qënë në qendër të rrëfimit letrar. Te libri i Dones *Burrnesha*¹¹⁰, për shembull, përmendjen në mënyrë të thatë të “racizmit të madh”¹¹¹ i lihet në dorë Fariut – një personazhi kalimtar –, ndërsa bëhet fjalë për dy djemtë e tij që u dërguan “në Itali, menjëherë mbas rrëzimit të regjimit komunist, me anijet e para”; “[k]anë shkuar në një qytet që quhet Trevizo, në veri”, “në ato anë mjafton të thuash <albanese> dhe të marrin për kriminel”. Megjithatë, sadoqë “në fillim kanë vuajtur mjaft”, mbasi që “kishin provuar Greqinë, që ishte akoma më keq”, “[u] kthyen prapë në Itali, afër Romës”. “Aty po iu ecën më mbarë. Roma është e madhe” dhe “ata janë punëtorë të zellshëm”.

Romani i Donesit, që doli në dritë në vitin 2007, përmbledh në vetvete

104 Nora Moll, “La narrativa di Amara Lakhous e i suoi intertesti”, in *La Rivista di Arablit. Semestrare di letteratura e cultura araba moderna e contemporanea*, anno IV, 7-8 (dicembre 2014): 177-187, këtu 186, https://www.academia.edu/9860825/_La_narrativa_di_Amara_Lakhous_e_i_suoi_intertesti_.

105 *Ibid.*

106 *Ibid.*

107 Amara Lakhous, *Scontro di civiltà per un ascensore a Piazza Vittorio*, Roma: edizioni e/o, 2006.

108 *Ivi*, 35.

109 Artur Spanjollit, *I nipoti di Scanderbeg*, Nardò <LE>: Besa, 2012.

110 Elvira Dones, *Vergine giurata*, Milano: Feltrinelli, 2007a. Bëhet fjalë për romanin e parë të autores të shkruar drejtpërdrejt në italisht. Krhs. dhe versionin shqip të romanit, *Hana* (përktheu nga italishtja Roland Sejko), Elbasan: Shtëpia Botuese Sejko, 2007b.

111 Dones 2007a, 149, si dhe citatet në vijim.

shenjat e para të “metamorfozës për të mirë të përceptimit të emigrantëve shqiptarë”¹¹². Këtu ka ndikuar padyshim edhe një lloj strategjie asimilimi e suksesshme që përdorën vetë shqiptarët, atë *Të hiqesh për italian*¹¹³, falë tipareve fizike të ngjashme dhe një njohjeje (paraprake) të gjuhës, kulturës, dhe mendësisë italiane. Nga sondazhet e bëra, për më tepër, ‘shqiptari’ dilte (asokohe) “i gatshëm, i besueshëm, respektues i autoriteteve dhe mbi të gjitha i gatshëm për të pranuar punë mjaft të lodhshme, me aftësi dhe vendosmëri, duke iu përmbajtur orareve”¹¹⁴. Këtu luajti një rol themelor edhe dalja në skenë e shenjestrave të reja ‘etnike’, me islamofobinë që pasoi mandej pas atentateve në Kullat Binjake (2001) dhe hyrjen e Rumanisë në BE (2007). Në lidhje me këtë, Lakhous flet për “armikun e radhës”¹¹⁵ duke e shpjeguar si më poshtë zgjedhjen e titullit të *bestseller*-it të sipërpërmendur të Stella-s (2002): “[i]shte i modës shqiptari grabitës dhe jo marokeni përdhunues [...]. Pas 11 shtatorit pamë edhe modën e muslimanit terrorist. Sot janë në modë romët.”¹¹⁶ Nuk duhet nënvleftësuar, në fund, roli i madh i luajtur nga disa programe tejet popullore të grupit televiziv *Mediaset* (para të gjithësh *Amici* dhe *C’è posta per te*, transmetuar të dy nga *Canale 5*, ideuar dhe drejtuar nga Maria De Filippi) – në përhapjen dhe promovimin e një imazhi të ri (virtuoz) të shqiptarëve, duke iu dhënë një hapësirë të barabartë me artistët italianë, aq sa në fund u kthyen në yje në nivel kombëtar. Vetë Gianni Amelio, regjisori i filmit *Lamerica*, do të pohonte se “[p]olitika është ajo që nuk arrin të kuptojë se për ekstrakomunitarët më shumë se njëqind konferenca serioze për imigracionin bën Maria De Filippi, me Kledin e saj, duke vlerësuar të rinj që shndërrohen në idhuj për fëmijët tanë. [...] Me balerinët e saj shqiptarë, ka çliruar një vend të tërë nga stereotipet dhe ka bërë histori. Nuk e di nëse e mbani mend, por para disa vitesh, në imagjinatën kolektive, fjala ‘albanese’ bënte rimë me fjalën vrasës.”¹¹⁷

Edhe sikur të kishte një listë të pëlqyeshmërisë të emigrantëve, “[m] odat, dihet, nuk janë kurrë të përjetëshme. Të jesh i modës do të thotë që

112 Pittau/ Ricci/ Urso 2009, 163.

113 Shih Vincenzo Romania, *Farsi passare per italiani. Strategie di mimetismo sociale*, Roma: Carocci, 2004.

114 Pittau/ Ricci/ Urso 2009, 162.

115 Lakhous 2011, 1.

116 *Ivi*.

117 Fabio Traversa, “Gianni Amelio: «Maria De Filippi con i ballerini albanesi ha fatto la storia e combattuto il razzismo più dei capi di stato»”, in *BLOGO - Informazione libera e indipendente*, 20.08.2015, <http://realityshow.blogosfere.it/post/671488/gianni-amelio-maria-de-filippi-ballerini-albanesi-amici>.

herët a vonë do të bëhesh demode”¹¹⁸, ajo shqiptare përbën padyshim një rast të veçantë. Diskriminimi antishqiptar i ditëve tona nuk duhet quajtur si një fazë kalimtare, që herët a vonë do të zëvendësohet nga një modë e re nga zhvillimi i natyrshëm i ngjarjeve, por përkundrazi një parathënie dramatike, si pasojë e zhvillimit të vrullshëm të ngjarjeve nga nevoja për të gjetur medoemos një kokë turku për të demonizuar gjendjen e emergjencës. Dhe në fakt ishte fjala për një parathënie, përfshirë në një *status quo* që nuk i ka harruar aspak shqiptarët – përkundrazi, i ka rivlerësuar – dhe mikpritjen e përzemërt fillestare që iu rezervua të parëve, ‘zbarkimeve të shpresës’, që qenë aq të mëdha, qysh në 1990. Tonet asokohe ishin vëllazërore dhe përsëritnin, pas pesëdhjetë vjetësh mbyllje të Shqipërisë, ato që kishin qenë deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, që mesa duket ekzistonin ende në vetëdijen kolektive.

Në përfundim, del pa hije dyshimi se është ndjenja filoshqiptare e tashme – dhe jo shqiptarofobia e dy dhjetëvjeçarëve të kaluar – që përfaqëson vijueshmërinë e një mendësie që ekzistonte qysh më parë. Kjo duhet parë në dritën (e rizbulimit) të një historie shekullore të përbashkët dhe të një afërsie të madhe kulturore dhe gjuhësore ndërmjet dy brigjeve detare. *Last but not least*, edhe paraqitja ikonografike mbështeti imperializmin kolonialist në Shqipëri. Kështu, nuk mund t’i shpjegojmë ndryshe shprehjet – gjithnjë e më të zakonshme – si kjo këtu: “[n]ëse pritja në Itali dhe në Europë e të gjithë shqiptarëve u pat shtyrë nga një arsye që duhet gjetur tek afërsia gjeografike, te ngjarjet historike, gjuhësore, të lidhjeve të përbashkëta shoqëro-politike, gjuhësore, dhe jo krejt në fund, tipare të përbashkëta si pasojë e zanafillës së përbashkët indoeuropiane, çfarë kanë të përbashkët me ne [italianët] popujt afrikanë që «s’kanë të bëjnë fare me Europën» (it. *comunque in Europa si troveranno sempre <come i cavoli a merenda>*)?”¹¹⁹

“Na ishte njëherë Lamerica”¹²⁰

Përktheu nga italishtja Arben Ndreca

118 Lakhous 2011, 1.

119 Koment publikuar në *Facebook* si replikë për një postim për emergjencën e emigracionit, 2.9.2015. Falenderoj shkrimtaren Leoreta Ndoci për përcjelljen e këtij citimi nga faqja e saj e *Facebook*-ut.

120 It. “C’era una volta Lamerica”, Berizzi 2013.

Abstract

As witnessed even by the counternarratives brought by Albanian italophone authors, the “Albanian case” reveals, within the Italian postcolonial context, a series of specific characteristics. These can be essentially traced back to a centuries-old intense contact between the two shores of the same sea. Since ancient times, the Albanian territory has been of continuous expansionist concern for the Italian peninsula, which, on the other side, represented the destination of various immigration waves raising from Albania. Initial hospitality – hostility and refusal – successful integration seem to form a paradigmatic sequencing, bound to be repeated throughout history. The current happy-end of a troubled integration path of the Albanian community, which has been for a long period the most rejected and stigmatized by the public discourse among all other ethnic groups, could find its explanation in the “privileged” nature of Italian colonialism in Albania, and more specifically in the iconographic construction of an imaginary of the “other” crystallized by the fascist rhetoric. This paper aims to focalize the crucial moments of the Italian discursive attitude towards the “Albanian matter”, which has been marked out over the centuries through a striking rhetorical shift, well expressed by the question raised from Dorothy Zinn: *Adriatic brethren or black sheep?*